



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1037/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hysen Isufaj kandidat për këshilltar në K.K. Junik nga radhët e Lëvizjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Junik, paraqitur kundër Qendra e Numrimit të Rezultateve (QNR), në Fushë Kosovë për shkak të parregullsive gjatë procesit të publikimit të rezultateve - manipulim të rezultateve, në raundin e dytë për zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hysen Isufaj kandidat për këshilltar në K.K. Junik nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Junik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, ku pretenduesi ka theksuar se pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ –së / QNR ka vërejtur se nuk është pasqyruar në rezultatet përfundimtare asnjë votë si kandidatë nga votat me kusht të cilat nuk numërohen në vendvotim por në QNR. Ndërsa informacionet e mija janë se së paku 1 (një) votë individuale e kam e kamë në pjesën e votave me kusht. Kjo për mua ka rëndësi se jemi 2(dy) kandidat me vota të barabarta dhe që kolegu që ka nr. Të barabartë votave është zgjedhur vetëm për shkak të numrit rendor që posedon në listën e certifikuar të kandidatëve nga ana e KQZ –së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të kandidatit për këshilltar Hysen Isufaj në K.K. Junik nga radhët e subjektit politikë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Junik, pretendohet se ka manipulim të votave të rezultatit përfundimtar, në këtë rastë parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme më të cilën do të vertetohej se është kryer një veprim i tillë, andaj një pretendim të tillë PZAP – i e konstaton u vlerësua si të pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 1037 /2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*